

VENDIM
Nr.788, date 26.11.2004

**PER PERCAKTIMIN E TARIFES DHE TE PESHES SE SHERBIMEVE TE
REZERVUARA PER OPERATORIN PUBLIK POSTAR**

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te neneve 3 pika 14 e 11 pika 1 shkronja "b" te ligjit nr.8530, date 23.9.1999 "Për shërbimin postar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Transportit dhe te Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimeve te rezervuara, te kryera nga operatori publik postar, për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve te korrespondencës se brendshme, te jete me e vogël se trefishi i tarifave publike për një objekt te korrespondencës për peshën me te vogël te kategorisë se standardeve me te shpejta, nëse ka kategori te tilla, me kusht qe pesha e tyre, te jete me e vogël se 100 gram.
2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano